



Pranimi / Dorezuar Punje / Prodato Received / Delivety	06.09.2023	3	viti god year
Organ / Shërbimi Org. / Unit	Pr Prot Pr. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSICK	5992/2023		13



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1043/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1043/2023, të datës 31.07.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë , kundër organit të punësimit Komuna e Podujevës, në çështjen administrative-juridike "Transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 ,nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 05.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.1043/2023 e datës 31.07.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.13-016/01-0053418/23 i datës 27.07.2023 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën "Zyrtar Ligjor 1" në Drejtorin për Administratë, me datë 31.07.2023, përmes emailit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit Nr.13-016/01-0053418/23 i datës 27.07.2023 për transferim të përkohshëm nga pozita "Zyrtar Ligjor 1" në kuadër të Drejtorisë për Administratë në pozitë të "Zyrtarit Ligjor 1" në kuadër të Drejtorisë së Arsimit, i cili vendim është nxjerrë nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës, ndërsa ankuesi nuk ka të specifikuar ndonjë pretendim konkretë në lidhje me këtë transferim, përveç që ka elaborue hapat që janë ndërmarrë në lidhje me këtë transferim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës. Ndërsa Këshilli me datë 15.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova:** Ankesën me nr.protokolli 5450/2023 të datës 31.07.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi Nr.13-016/01-0053418/23 i datës 27.07.2023 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; Email i datës 08.08.2023 nga ankuesi; Përgjigjja në kërkesë e organit të punësimit e datës 15.08.2023; Formular për kërkesë apo ankesë e datës 26.07.2023 me nr.05-615/03-0053237/23; Pëlqim për Transferim nga DKA Komuna e Podujevës e datës 26.07.2023; Formular për kërkesë apo ankesë e datës 26.07.2023 me nr.03-016/03-0053030/23; Kërkesë për transferim me nr.05-318 e datës 26.07.2023; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën e Zyrtarit Ligjor; Akt emërimi i ankuesit me numër AE.Nr.13-101/03-0079534/2021 i datës 01.09.2021; Lista e pagave për ankuesin e muajit Korrik 2023; Lista e pagave për ankuesen e muajit Qershor 2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në lidhje me objektin e kësaj ankese konstaton se kërkesën për transferim nga Drejtorja e Administratës e ka iniciuar Drejtori i Drejtorisë së Arsimit përmes shkresës me numër protokoll 05-318 të datës 26.07.2023 me arsyetimin se për shkak të volumit të punës në këtë drejtori, për shkak të mungesës së sekretarëve të shkollave dhe zyrtarit ligjor në DKA të na mundësohet transferimi i një zyrtari ligjorë në drejtorin e arsimit, ndërsa përmes shkresës të datës 26.07.2023 në lidhje me këtë kërkesë pëlqimin e ka dhënë U.d Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës, në të cilën drejtori ankuesi e ka vendin e përhershëm të punës sipas aktemrimit.Ndërsa bazuar në arsyet si më lartë ankuesi është transferuar përkohësisht për interes të institucionit për periudhën tre (3) mujore duke filluar nga data 27.07.2023 deri më 26.10.2023 sipas Vendimit me nr.13-016/01-0053418/23 të datës 27.07.2023 të nxjerrë nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në lidhje me këtë çështje duke e kuptuar qëllimin e ankuesit përkundër që i njëjti nuk ka specifikuar pretendimet ankimore thekson faktin se bazuar në Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publik nenin 52, paragrafi 1.1 ku thuhet se: 1. *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve;* si dhe Rregullores (QRK) nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, nenin 4 ku thuhet se: 1. *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit. 2. Transferimi i përkohshëm në rastet e parashikuara në Nenin 52, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit, nuk mund të bëhet për nëpunësit civilë në periudhën provë. 3. Në kuptim të Nenit 52. paragrafit 1, nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit, në periudhën dy (2) vjeçare të viteve të punës*

nuk llogaritet koha e periudhës provuese. 4. Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit. 5. Pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme”, ndërsa sipas nenit 5 të po të njëjtës rregullore transferimi në interes të institucionit është e rregulluar specifikisht dhe at si në vijim:”1.Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit me kërkesë të institucionit. Në rastet kur nëpunësi civil kërkohet të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, të ndryshëm nga institucioni ku ai është i emëruar, institucioni që paraqet kërkesën për transferimin e përkohshëm duhet të marrë paraprakisht miratimin e institucionit ku nëpunësi civil është i punësuar. 2. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësi përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësi përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimin nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet. 3.Nëpunësi civil gjithashtu mund të transferohet përkohësisht, për nevojat e institucionit apo shtetit, në një organizatë ndërkombëtare, në të cilën Republika e Kosovës është anëtare apo në një institucion ndërkombëtar”.

Andaj bazuar në rrethanat e tilla ligjore të specifikuara si më lartë kolegji i këshillit konstaton se transferimi i përkohshëm i ankuesit është bërë në interes të institucionit për shkak të nevojave dhe vëllimit të punës në Drejtorin e Arsimit , ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se me rastin e këtij transferi të përkohshëm janë respektuar dispozitat e specifikuara më lartë që në mënyrë të hollësishme e rregullojnë çështjen e transferimit të përkohshëm në interes të institucionit, dhe mbi këtë bazë ligjore ankesa është e pabazuar.

Nga ajo që u tha si më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda,A.nr.1043/2023, datë 05/09/2023

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.